

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATIZATION AGENCY OF KOSOVO RELATED MATTERS	POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU
--	---	--

SCEL - 11-0021

Ankuesit

Punëtorët e NSH-së “XX”, XX

C1 I.G., XX

C2 H.M., XX

C3 B.B., XX

C4 R.S., XX

C5 F.J., XX

C6 R.S.M., XX

C7/1 M.J., XX

përfaqësuar nga avokate XX, XX

C7/2 J.Q., XX

përfaqësuar nga avokate XX, XX

C8 R.M., XX

Kundër

I padituri

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

Rruga Ilir Konushevci nr. 8, Prishtinë

Kolegji i Specializuar 1 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit i përbërë nga Gjyqtari Kryesues Alfred Graf von Keyserlingk, Gjyqtari Shkelzen Sylaj dhe Gjyqtari Çerim Fazliji, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 22 shkurt 2013, lëshon këtë

AKTGJYKIM

1. Ankesat e M.J. (ankuesi C7/1), J.Q. (ankuesi C7/2) dhe R.M. (ankuesi C8) hedhen poshtë si të papranueshme.

2. Ankesat e ankuesve H.M.(ankuesi C2), B.B.(ankuesi C3), R.S. (ankuesi C4) dhe F.J.(ankuesi C5) janë të bazuara. Këta ankues duhet të përfshihen në listën përfundimtare të punëtorëve me të

drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat nga privatizimi i NSH-së XX, XX.

3. Ankesat e I.G.(ankuesi C1) dhe R.S.M.(ankuesi C6) refuzohen si të pabazuara.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Ankuesit janë ish punëtorë të ndërmarrjes shoqërore NSH XX, XX (NSH-ja) e cila ishte privatizuar me spin-off të rregullt nga i padituri. Kontrata e shitjes me ofertuesin fitues ishte ratifikuar më 04.05.2009.

Lista e përkohshme e punëtorëve me të drejta legjitime ishte publikuar më 05.09.2009 dhe data e fundit për dorëzimin e ankesave në AKP kundër listës së përkohshme ishte më 25.09.2009.

Lista përfundimtare ishte publikuar më 7, 8, 9 dhe 10 prill 2011 me afat të fundit më 30 prill 2011 për parashtrimin e ankesave në Dhomën e Posaçme.

Më 20 prill 2011 **I.G.(ankuesi C1)** parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej “AKP”) duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të fituar 20% nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi e kundërshton vendimin e AKP-së me të cilin ai përjashtohet nga lista e përkohshme mbi bazën se nuk i ka plotësuar kushtet ligjore. Ankuesi deklaroi se ai ishte i punësuar në NSH për më shumë se 30 vite, nga data 28.08.1979 deri më 08.02.2009 kur shkoi në pension. Ai pohoi se i plotëson të gjitha kushtet dhe përjashtimi i tij nga lista është diskriminim ndaj tij. Ai ka dorëzuar librezën e punës.

Në komentet me shkrim të datës 26 maj 2011, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar sepse marrëdhënia e punës e ankuesit kishte përfunduar më 08.02.2009, siç dëshmohet në librezën e punës dhe më 10.01.2009 sipas Librit Amë të NSH-së. Prandaj, ankuesi nuk i plotëson kushtet për të qenë në listë.

Në përgjigjen e datës 1 shkurt 2012, ankuesi paraqet se ai më 08.02.2009 arriti moshën 65 vjeçare dhe se ajo ishte arsyeja e përfundimit të marrëdhënies së tij të punës.

Më 27 prill 2011 **H.M. (ankuesi C2)** parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve

me të drejta legjitime për të fituar 20% nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi deklaroi se ai ishte i punësuar në NSH për më shumë se 17 vite, nga viti 1972 deri më 08.05.1998 kur u largua nga puna për shkak të diskriminimit që ishte bërë nga qeveria serbe kundër punëtorëve shqiptarë. Pas përfundimit të konfliktit në vitin 1999 ai u kthye në punë, megjithatë, drejtori i NSH-së i tha që të kthehej në shtëpi dhe të priste derisa t'a thërrisnin, por kurrë nuk e bënë një gjë të tillë. Ai ka dorëzuar librezën e punës.

Në komentet me shkrim të datës 31 maj 2011, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar sepse marrëdhënia e punës e ankuesit kishte përfunduar më 21.06.1995, siç dëshmohet në librezën e punës dhe në Librin Amë të NSH-së. Prandaj, ankuesi nuk i plotëson kushtet për të qenë në listë.

Në përgjigjen e datës 1 shkurt 2012, ankuesi paraqet se marrëdhënia e tij e punës kishte përfunduar para datës së privatizimit sepse ai ishte larguar nga puna në baza diskriminuese kundër dëshirës së tij.

Më 27 prill 2011 **B.B. (ankuesi C3)** parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të fituar 20% nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi deklaroi se ai ishte i punësuar në NSH nga viti 1971 deri më 08.05.1998 kur u largua nga puna për shkak të diskriminimit që ishte bërë nga qeveria serbe kundër punëtorëve shqiptarë. Pas përfundimit të konfliktit në vitin 1999 ai u kthye në punë, megjithatë, drejtori i NSH-së i tha që të kthehej në shtëpi dhe të priste derisa t'a thërrisnin, por kurrë nuk e bënë një gjë të tillë. Ai ka dorëzuar librezën e punës.

Në komentet me shkrim të datës 31 maj 2011, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar sepse marrëdhënia e punës e ankuesit kishte përfunduar më 21.06.1995, siç dëshmohet në librezën e punës dhe në Librin Amë të NSH-së. Prandaj, ankuesi nuk i plotëson kushtet për të qenë në listë.

Në përgjigjen e datës 1 shkurt 2012, ankuesi paraqet se marrëdhënia e tij e punës kishte përfunduar para datës së privatizimit sepse ai ishte larguar nga puna në baza diskriminuese kundër dëshirës së tij.

Më 27 prill 2011 **R.S.(ankuesi C4)** parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të fituar 20% nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi deklaroi se ai ishte i punësuar në NSH nga viti 1972

deri më 08.05.1998 kur u largua nga puna për shkak të diskriminimit që ishte bërë nga qeveria serbe kundër punëtorëve shqiptarë. Pas përfundimit të konfliktit në vitin 1999 ai u kthye në punë, megjithatë, drejtori i NSH-së i tha që të kthehej në shtëpi dhe të priste derisa t'a thërrisnin, por kurrë nuk e bënë një gjë të tillë. Ai ka dorëzuar librezën e punës.

Në komentet me shkrim të datës 31 maj 2011, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar sepse marrëdhënia e punës e ankuesit kishte përfunduar më 21.06.1995, siç dëshmohet në librezën e punës dhe në Librin Amë të NSH-së. Prandaj, ankuesi nuk i plotëson kushtet për të qenë në listë.

Në përgjigjen e datës 2 shkurt 2012, ankuesi paraqet se marrëdhënia e tij e punës kishte përfunduar para datës së privatizimit sepse ai ishte larguar nga puna në baza diskriminuese kundër dëshirës së tij.

Më 27 prill 2011 **F.J.(ankuesi C5)** parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të fituar 20% nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi deklaroi se ai ishte i punësuar në NSH nga viti 1979 deri më 08.05.1998 kur u largua nga puna për shkak të diskriminimit që ishte bërë nga qeveria serbe kundër punëtorëve shqiptarë. Pas përfundimit të konfliktit në vitin 1999 ai u kthye në punë, megjithatë, drejtori i NSH-së i tha që të kthehej në shtëpi dhe të priste derisa t'a thërrisnin, por kurrë nuk e bënë një gjë të tillë. Ai ka dorëzuar librezën e punës.

Në komentet me shkrim të datës 31 maj 2011, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar sepse marrëdhënia e punës e ankuesit kishte përfunduar më 21.06.1995, siç dëshmohet në librezën e punës dhe në Librin Amë të NSH-së. Prandaj, ankuesi nuk i plotëson kushtet për të qenë në listë.

Në përgjigjen e datës 2 shkurt 2012, ankuesi paraqet se marrëdhënia e tij e punës kishte përfunduar para datës së privatizimit sepse ai ishte larguar nga puna në baza diskriminuese kundër dëshirës së tij.

Më 27 prill 2011 **R.S.M.(ankuesi C6)** parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të fituar 20% nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi kundërshtoi vendimin e AKP-së për mospërfshirjen e tij në listën e punëtorëve. Ankuesi deklaroi se ai ka punuar në NSH për më shumë se 8 vite prandaj edhe i plotëson kushtet ligjore për të qenë në listë. Ai ka dorëzuar librezën e punës.

Në komentet me shkrim të datës 30 maj 2011, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk e kishte parashtruar ankesën në Agjenci kundër listës së punëtorëve. AKP-ja argumenton se ankuesi nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet administrative të ankimit para se t'i drejtohej gjykatës siç kërkohet me nenin 127.4 të Ligjit Nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative.

Më 27 qershor 2011 **M.J. (ankuesi C7/1)** parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të fituar 20% nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi e kundërshton vendimin e AKP-së për mospërfshirjen e tij në listën e punëtorëve. Ankuesi deklaron se ai ka punuar në NSH nga viti 1968 deri në fund të vitit 1999. Ai deklaron se ka punuar deri në fund të vitit 1999; ai thekson se askush nuk ka punuar në NSH pas vitit 1999 sepse NSH-ja nuk ishte funksionale. Ai ka dorëzuar librezën e punës.

Në komentet me shkrim të datës 11 korrik 2011, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse afati për parashtrimin e ankesave në Dhomën e Posaçme ishte deri më 30 prill 2011, ndërsa ankesa ishte parashtruar më 27 qershor 2011.

Në përgjigjen e datës 30 janar 2013, ankuesi deklaron se i kishte ikur afati për shkak se është i moshuar dhe i sëmurë.

Më 27 qershor 2011 **J.Q. (ankuesi C7/2)** parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të fituar 20% nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi e kundërshton vendimin e AKP-së për mospërfshirjen e tij në listën e punëtorëve. Ankuesi deklaron se ai ka punuar në NSH për 22 vite, nga viti 1967 deri në fund të vitit 1999. Ai deklaron se ka punuar deri në fund të vitit 1999; ai thekson se askush nuk ka punuar në NSH pas vitit 1999 sepse NSH-ja nuk ishte funksionale. Ai ka dorëzuar librezën e punës.

Në komentet me shkrim të datës 11 korrik 2011, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse afati për parashtrimin e ankesave në Dhomën e Posaçme ishte deri më 30 prill 2011, ndërsa ankesa ishte parashtruar më 27 qershor 2011.

Në përgjigjen e datës 30 janar 2013, ankuesi deklaron se i kishte ikur afati për shkak se është i moshuar dhe i sëmurë.

Më 29 shtator 2011 **R.M. (ankuesi C8)** parashtrori ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të fituar 20% nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi e kundërshton vendimin e AKP-së për mospërfshirjen e tij në listën e punëtorëve në bazë të mbylljes së librezës së punës. Ankuesi deklaroi se ka qenë punëtor i NSH-së dhe për këtë arsye i plotëson kushtet për të qenë në listë. Ai ka dorëzuar librezën e punës.

Në komentet me shkrim të datës 6 tetor 2011, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse afati për parashtrimin e ankesave në Dhomën e Posaçme ishte deri më 30 prill 2011, ndërsa ankesa ishte parashtruar më 29 shtator 2011.

Lidhur me detajet tjera referimi i është bërë dosjes së gjykatës.

Arsyetimi ligjor

Vendimi lëshohet pa mbajtur seancë dëgjimore sepse faktet dhe argumentet ligjore të dorëzuara janë mjaftë të qarta. Kolegji nuk pret që në seancë të ketë më tepër informacione dhe argumente relevante (neni 68.11 i Shtojcës së Ligjit mbi Dhomën e Posaçme)

Pranueshmëria

Ankesat e **M.J. (ankuesi C7/1)**, **J.Q. (ankuesi C7/2)** dhe **R.M. (ankuesi C8)** janë të pranueshme.

Sipas nenit 67.6 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2008/6 në lidhje me nenin 10.6(a) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13, ankesa kundër listës përfundimtare duhet të dorëzohet brenda 20 ditëve pas shpalljes së listës përfundimtare. Publikimi është bërë më 7, 8, 9 dhe 10 prill 2011. Këto ankesa janë dorëzuar pas afatit.

Të gjitha ankesat tjera janë të pranueshme.

Ato janë dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në nenin 67.6 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2008/6 në lidhje me nenin 10.6(a) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13.

Lëshimi i ankuesve për të kundërshtuar Listën e Përkohshme sipas nenit 67.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2008/6 nuk e bën ankesën kundër Listës Përfundimtare të papranueshme.

- a. Neni 127 i Ligjit Nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative nuk zbatohet. Neni 127 thotë

“Ankimi administrativ

127.1. Ankimi administrativ mund të bëhet në formë të kërkesës për rishqyrtim ose të ankesës.

127.2. Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet kundër një akti administrativ ose kundër refuzimit të paligjshëm për nxjerrjen e aktit administrativ.

127.3. Organi administrativ të cilit i drejtohet ankimi shqyrton ligjshmërinë dhe rregullsinë e aktit të kontestuar.

127.4. Palët e interesuara mund t’i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë shteruar mjetet administrative të ankimit.”

Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut Nr. 2008/6 në nenin 70.3 (a) dhe (b) nën titullin Ligji në fuqi nuk i referohet Ligjit Nr. 02/L-028 mbi Procedurën Administrative por i referohet Ligjit mbi Procedurën Kontestimore i cili nuk përmban ndonjë dispozitë ku kërkohet shterimi i të gjitha mjeteve administrative para drejtimit në gjykatë.

Por edhe nëse do të zbatohet Neni 127 i Ligjit Nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative, ankuesit nuk do të kishin nevojë të kundërshtojnë Listën e Përkohshme para se të ankoheshin kundër listës përfundimtare. Ankesa e tyre nuk ka të bëjë me Listën e Përkohshme (e cila do të kundërshtohet) por me Listën Përfundimtare (kundër të cilës nuk është i mundur asnjë mjet administrativ).

- b. Edhe formulimi i fjalisë së parë të nenit 67.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2008/6 nuk mund të interpretohet në atë mënyrë që punëtori duhet të kundërshtojë Listën e Përkohshme në mënyrë që më vonë të ketë të drejtë të ankohet kundër Listës Përfundimtare. Fjalja e parë e nenit 67.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2008/6 thotë:

“Pas pranimit të listës së punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit publikon një listë të përkohshme të punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën bashkë me një njoftim për publikun mbi të drejtën e çdo personi që brenda 20 ditësh të parashtrijë ankesë në këtë agjenci për përfshirje në listë ose kundërshtimin e listës së punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën.”

Ligji thotë vetëm e drejtë për të kundërshtuar listën e përkohshme, por nuk thotë se ai që nuk e kundërshton listën e përkohshme nuk mund të kundërshtojë më vonë listën përfundimtare.

- c. Kolegji është në dijeni, se obligimi për të kundërshtuar çfarëdo mangësie në listën e përkohshme i kombinuar me sanksionimin se nëse kjo nuk bëhet, ankesa kundër listës përfundimtare bëhet e papranueshme do t'a ndihmonte Agjencinë që, në një kohë më të shkurtër, të krijonte listën përfundimtare të korigjuar.

Procedura që në fillim të krijohet Lista e Përkohshme dhe t'u jepet mundësia të gjithëve që të kundërshtojnë këtë listë dhe të dorëzojnë faktet dhe provat brenda 20 ditëve do t'a ndihmojë AKP-në të krijojë Listën e korigjuar Përfundimtare pa vonesa të panevojshme. Ajo ka për qëllim që të përqendrohet dhe të shpejtojë procedurën. Mbledhja sa më e hershme e të gjitha fakteve dhe provave të nevojshme është një aset themelor në kontekstin procedural në të cilën shuma monetare e pjesës së 20% për çdo punëtor varet në vendimin mbi pranimin apo refuzimin e ankesave të parashtruara.

Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2008/6 nuk lejon që të sanksionohet mungesa e bashkëpunimit të Punëtorit në fazën e krijimit të Listës Përfundimtare duke e bërë ankesën kundër Listës Përfundimtare të papranueshme (ngjashëm: Aktgjykimet SCEL-09-0001 dhe SCEL-10-0027 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme).

Arsyetimi mbi bazueshmërinë

Ankesat e ankuesve **H.M.(ankuesi C2)**, **B.B.(ankuesi C3)**, **R.S. (ankuesi C4)** and **F.J.(ankuesi C5)** janë të bazuara.

Këta ankues që të gjithë kanë shërbyer për më shumë se tre vite në NSH dhe të gjithë janë larguar nga puna gjatë administratës së përkohshme serbe. Ata të gjithë pretendojnë se kjo ishte për shkak të përkatësisë së tyre etnike shqiptare.

Neni 10.6(b) i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/45, e paraqet procedurën për parashtrimin e ankesës mbi bazën e diskriminimit në Dhomën e Posaçme si vijon:

“Çfarëdo ankese e dorëzuar në Dhomën e Posaçme me bazë diskriminimin si shkak për mospërfshirjen në listën e të punësuarve me të drejta legjitime, duhet të shoqërohet me dëshmi të dokumentuara për diskriminimin e pretenduar.”

Ankuesit nuk i kanë plotësuar këto kushte.

Megjithatë, neni 8 i Ligjit Kundër Diskriminimit, në lidhje me barrën e provave, thotë si vijon:

“8.1. Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin faktet para organit administrativ apo Gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

8.2. Paragrafi 8.1 nuk ndalon zbatimin e rregullave të dëshmimit të cilat janë të favorshme për palën paditëse. Paditësi mund të mbrojë rastin e tij të diskriminimit edhe me metoda të tjera përfshirë edhe shfrytëzimin e dëshmive statistikore.”

Neni 11 i të njëjtit ligj thotë:

“11.1 Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë të zbatohen të gjitha ligjet e mëparshme nga kjo fushë.

11.2. Dispozitat e legjislacionit që do të nxirren dhe dispozitat në fuqi lidhur me mbrojtjen e parimit të trajtimit të barabartë vlejnë dhe duhet të zbatohen edhe më tutje nëse janë më të favorshme se dispozitat e këtij ligji.”

Tani nuk është më ankuesit që duhet të dëshmojë diskriminimin por i padituri ai që duhet të dëshmojë se nuk ka pasur diskriminim. Barra e provës, e cila sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13 duhet të bartej nga ankuesit ka kaluar tek i padituri me Ligjin Nr. 2004/3 Kundër Diskriminimit (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/32).

Largimi nga puna i personave të përkatësisë etnike shqiptare gjatë administratës së përkohshme serbe është një fakt nga i cili mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Në vitet 1990 u miratuan disa rezoluta nga Asambleja e Përgjithshme dhe nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, mes të cilave Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme nr. 48/153 e datës 20 dhjetor 1993, e cila e njeh ekzistimin e (dhe dënon) – mes tjerash – ‘... masat dhe praktikat e

diskriminimit dhe shkeljet e të drejtave të njeriut të shqiptarëve të Kosovës, si dhe represionin e madh të bërë nga autoritetet serbe, duke përfshirë: ... b. Largimin diskriminues të zyrtarëve shqiptarë, veçanërisht nga policia dhe gjyqësori, largimin masiv të shqiptarëve nga pozitat profesionale, administrative dhe pozitat tjera të kualifikuara në ndërmarrjet shoqërore dhe institucionet publike, duke përfshirë mësuesit nga sistemi shkollor i drejtuar nga serbët ...’.

Si pasojë e të ashtuquajturave “Masa të Përkohshme” të vëna në NSH, menaxhmenti shqiptar u largua dhe u zëvendësua me menaxhmentin serb (shih “Ligji mbi Masat e Përkohshme për Mbrojtjen Shoqërore të të Drejtave Vetë-Menaxhuese dhe të Pronës Shoqërore”, publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës Socialiste të Serbisë nr. 49 të datës 28 tetor 1989, i cili nuk është ligj në fuqi, duke përmbajtur elemente diskriminuese, sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24).

Ia vlen që të citohen disa fjali nga dy prej disa raporteve mbi gjendjen në Kosovë gjatë viteve 1990ta nga Organizata për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut “Human Rights Watch”. Raporti i quajtur “Helsinki Watch: Report” (një divizion i Organizatës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut “Human Rights Watch”), në gusht 1992, në faqen 52, thotë: *“Qindra mijëra shqiptarë kanë humbur punët e tyre mbi bazat etnike, në veçanti në vitin 1991. Fushat ligjore, mjekësore dhe të profesioneve të tjera janë spastruar thuajse plotësisht nga shqiptarët dhe janë zëvendësuar nga serbët dhe malazezët”*; dhe Raporti Botëror i vitit 1996 i Organizatës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut *“Human Rights Watch World Report 1996 – Republika Federative e Jugosllavisë”* i datës 1 janar 1996 thotë: *“Në fund të vitit 1995, përafërsisht tre të katërtat e numrit të përgjithshëm të ish punëtorëve shqiptarë janë larguar nga vendet e tyre të punës”* (Aktgjykimi SCCL-09-0001 i DHPGJS-së i datës 10 qershor 2011).

I padituri as nuk pretendoi arsye tjera veçse diskriminim e as nuk dëshmoi arsye tjera veçse diskriminim. Prandaj, kolegji vlerëson se këta ankues të përkatësisë etnike shqiptare kanë humbur vendet e tyre të punës në NSH nga diskriminimi. Ata duhet të pranohen listën përfundimtare.

Ankesa e **I.G. (ankuesi C1)** është e pabazuar. Ai nuk ishte punëtor i NSH-së më 04.05.2009, atëherë kur ndodhi privatizimi. Ai vetë ka pretenduar se marrëdhënia e tij e punës ka përfunduar më 08.02.2009 kur ka shkuar në pension.

Ankesa e **R.S.M. (ankuesi C6)** është e pabazuar. Ai ka punuar në NSH për më shumë se tetë vite, por në datën e privatizimit ai nuk ishte më i

punësuar në NSH dhe ai as nuk pretendon dhe as nuk ka ndonjë të dhënë se marrëdhënia e tij e punës ka përfunduar me masë diskriminuese.

Shpenzimet gjyqësore

Gjykata nuk cakton shpenzime për Ankuesit pasi që Presidiumi i gjykatës deri më tani nuk ka lëshuar ndonjë plan me shkrim i cili është miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (neni 57, paragrafi 2, i Ligjit mbi Dhomën e Posaçme). Kjo do të thotë se deri tani nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për të ngarkuar shpenzime.

Këshillë ligjore

Kundër këtij Aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë brenda 21 ditësh tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme. Ankesa duhet t'u dërgohet edhe palëve tjera dhe tek Trupi Gjyqësor nga apeluesi brenda 21 ditësh. Apeluesi duhet të dorëzojë tek Kolegji i Apelit dëshminë se e ka dërguar apelin tek palët tjera.

Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur apeluesit i është dërguar Aktgjykimi me shkrim.

Kolegji i Apelit e refuzon ankesën si të papranueshme nëse apeluesi nuk e parashtron atë brenda afatit të paraparë.

I Padituri mund të parashtrojë përgjigje tek Kolegji i Apelit brenda 21 ditëve nga data kur i është dërguar ankesa, duke e dërguar përgjigjen edhe tek apeluesi dhe tek palët tjera.

Apeluesi pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja në ankesën e tij, për ta dorëzuar përgjigjen e vet tek Kolegji i Apelit dhe për ta dërguar atë tek pala tjetër. Pala tjetër pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja e ankuesit që të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij tek apeluesi dhe tek Kolegji i Apelit.

Alfred Graf von Keyserlingk
Gjyqtar Kryesues

[nënshkruar]